REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 18 Prot. Tiranë, më 27/07/2020

**VENDIM**

**Nr. 13, Datë 27/07/2020**

**"MBI MIRATIMIN E TABELAVE TË REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE TË PROCESIT ZGJEDHOR 2020 NË UNIVERSITETIN E ARTEVE PER ORGANET DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK; MENYRES SE PERLLOGARITJES SE REZULTATEVE DHE VULOSJES SE FLETEVE TE VOTIMIT"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; urdhrave të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8, datë 14.01.2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë" (i ndryshuar); me nr. 108, datë 08.05.2020 ''Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga pandemia e COVID-19'', me nr. 175, datë 30.06.2020 ''Zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në IAL-të Publike në Republikën e Shqipërisë'', si dhe të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", miratuar me vendim të Senatit Akademik, nr. 19, datë 10.02.2020, në mbledhjen e datës 27.07.2020, pasi diskutoi, me votim të hapur,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e tabelave mbi rezultatet perfundimtare te procesit zgjedhor 2020 per Organet Drejtuese dhe Senatin Akademik, sipas formatit bashkengjitur ketij vendimi.
2. Menyra e perllogaritjes se votave per autoritetet drejtuese, per te cilat votojne edhe studente, do te jete varianti **A**, parashikuar ne Rregulloren e Zgjedhjeve, neni **35**, pika **10**, shkronja **a;**
3. Vula e KIZ do te vendoset ne fund te fletes, ne anen e djathte te pjeses se pasme te saj;
4. Vula e KZF-se, siç parashikohet ne Rregullore, do te vendoset ne anen e majte, ne fillim te fletes, ne pjesen e pasme te saj;

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Ky vendim te dergohet prane KZF-ve te Fakulteteve perkatese;
Ky vendim te publikohet ne faqen zyrtare elektronike te UART;

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë**

| Ergys Krisiko | Orges Malaj | Ted Kamberi | Albjon Begaj |
|---|---|---|---|
| **Anëtar** | **Anëtar** | **Anëtar** | **Anëtar** |

Suela Agolli
**Kryetar**

**Sekretar:** Armira Kapxhiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE KIZ 2020